# AGJENDA TRAINIM

Shkodër, 15 Korrik 2024

Qendra Rinore ARKA, Rruga Palok Kurti, Shkodër, Albania

**Titull:**

Shoqëria Civile dhe Parlamenti në Procesin e Hartimit, Konsultimit dhe Miratimit të Buxhetit të Shtetit

**Organizator:**

AIS promotor i Open Data Albania

**Projekti dhe Partneriteti:**

Rritja e Përgjegjshmërisë së Parlamentit ndaj shqetësimeve të Qytetarëve, Projekt i mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar nga një konsorcium drejtuar nga IDM në partneritet me Citizens Channel dhe AIS.

**Objektiv:**

Ngritja e kapaciteteve të OSHC-ve, aktivistëve dhe mediave lokale për të kontribuar në planifikimin e buxhetit të shtetit dhe për politikat e shpenzimeve publike

**Zona:**

Rajonet: Lezhë; Dibër; Shkodër; Kamzë; Kukës; Tiranë; Malësi e Madhe

**Target:**

Përfaqësues të Shoqërisë Civile; Aktivist dhe Gazetarë Lokal

## Parashtrim Projekti

Me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Tiranë, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në partneritet me Citizens Channel dhe me Institutin Shqiptar të Shkencave (AIS), do të zbatojnë projektin *"Rritja e përgjegjshmërisë së parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve"*. Ky projekt ka për qëllim të forcojë përpjekjet e parlamentit për të nxitur një mjedis mundësues për angazhim të qenësishëm të qytetarëve në proceset e politikave dhe legjislative në vend, si një mjet për të nxitur interesin publik dhe ndërtimin e besimit ndaj institucionit.

## Parashtrim Aktiviteti

Ky Trajnim që do të mbahet në muajin Korrik 2024 në dy nga Rajonet e targetuara, ka si synim rritje të kapaciteteve të shoqërisë civile dhe përmirësim të tyre në njohjen dhe pjesëmarrje gjatë ciklit të Buxhetimit në Parlament. Trajnimi synon aftësim për të kuptuar dhe monitoruar Procesin e Hartimit, Miratimit dhe Raportimit të Buxhetit të Shtetit në Parlament. Ngritje e kapaciteteve të tyre për të reaguar dhe marrë pjesë gjatë procesit të Planifikimit dhe Miratimit të Buxhetit të Shtetit dhe Politikave që lidhen me Financat Publike. Trajnimi synon edhe prezantimin e Instrumenteve të Mundshëm Ligjor për pjesëmarrjen, propozime apo seanca dëgjimore në Komisione Kuvendore.

## Target:

Aktivist, Gazetarë dhe Përfaqësues të Organizatave jo Qeveritare.

| | |
|---|---|
| **9.45 – 10:00** | Regjistrimi i Pjesëmarrësve |
| **10:00 - 10:45** | **Leksion: Buxheti i Shtetit si një Instrument i Rëndësishëm Kushtetues**<br>• Hartimi, Zbatimi dhe Raportimi i Buxhetit<br>• Procesi i Zbatimit dhe i Raportimit të Buxhetit<br>• Shpenzime dhe të ardhura Qeveritare<br>• Seanca Dëgjimore për Hartimin e Buxhetit<br>• Aktorët Civil dhe Instrumentet e Pjesëmarrjes Parlamentare për Buxhetin<br>• Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Raporti mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit  Pyetje dhe Përgjigje. Diskutim<br><br>Trajner: ARANITA BRAHAJ, EKSPERT LIGJOR |
| **10:45 – 11.30** | **Ushtrim Praktik**<br>Instrumente dhe Mundësi të një Organizate. Grup Interesi apo Komuniteti Lokal të kërkojë të dëgjohet dhe të propozojë çështje që lidhen me Buxhetimin në Kuvend.<br>Buxheti për Sektor, Projekte dhe Investime. Listim i etapave dhe zhvillimet që çojnë në një Propozim të Suksesshëm.<br><br>Lehtësues: PAJTIM NIKOLLI |
| **11:30- 12:00** | **Pushim** |
| **12.00 – 13.15** | **Leksion: Buxhetimi Publik dhe Impakti Rajonal. Shpërndarja e Programeve dhe Investimeve në Qarqe**<br>• Dallimi mes Buxhetit Qeveritar dhe Buxheteve Lokale<br>• Të ardhurat e Pushtetit Vendor dhe rialokimet përmes Buxhetit të Shtetit<br>• Fondi i Zhvillimit të Rajoneve<br>• Rregulla të Caktimit të Transfertave të Pakushtëzuara. Qëllimi dhe Ecuria<br>• Impakti i Buxhetit të Shtetit në Zhvillimin e Investimeve Rajonale<br>• Ilustrimi përmes Artikujve të Publikuar në Open Data Albania<br>• Roli i Përfaqësuesit të Popullit, Deputeti dhe Shpërndarja e Parave Publike<br><br>Trajner: BLERINA LESI, EKSPERT FINANCA PUBLIKE |
| **13.15 – 14.00** | **Pune Praktike: Advokim mbi një Kauzë ku kërkohet nga Parlamenti Buxhetim më i mirë për Projekt/ Funksion apo Grup Interesi**<br><br>Trajner : AIS TEAM |
| | **Diskutime dhe Konkluzione.** |